

## **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** “Ndërtimi i Kabinave të reja Banaj- 4, Banaj- 5 dhe rikonstrukcioni i rrjetit TU të tyre me kabëll ABC”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**  
45231400-9 Puna e ndërtimit për linjat e energjisë elektrike

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 8,669,423 (*tetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e njëzetë e tre*) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a Berat ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

### **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

#### **1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës nr. 3*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, jo më të vogël se 40% të fondit limit të kontratës objekt prokurimi.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e perlllogaritur e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar (neni 43, pika 2, germa ”c” e VKM nr. 285, datë 19.05.2021)

Duke marrë në konsideratë sasine e mallrave dhe punimet objekt procedure prokurimi, kërkohej që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros duhet të jete në masën 40% të fonit limit

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,  
ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

*Në rast bashkimi të opratoreve, pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (neni 88, piak 3 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”).*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.
2. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Konkretisht, për kontrata të realizuara me **sektorin privat**, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- *Situacionin përfundimtar të objektit*
- *Fatura tatimore*
- *Vertetim per kyerjen me sukses te kontrates*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 gërma ”a” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vleren 30 % të

vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

---

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve me objekt kontrate, të lëshuar nga autoritetet kompetente, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- N.P. 1- A Punime gërmimi në tokë
- N.P- 11- C Ndertime për n/stacionet,kab transformacionit,linjatTN e te mesem dhe shperndarjen e energjise.

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- N.S –18 - A Punime topogjeodezike.

\*Ne rast të bashkimit të operatore ekonomike, Licencat profesionale duhet t’i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsiper punimet për të cilat kerkohet Licenca Profesionale.

\*Kur Operatori Ekonomik eshte i huaj ai duhet te paraqese licencen e ekivalentuar me kategorie e kerkuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “

Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
N.P1	Punime germimmi ne toke	Germim gropash shtyllash	A
N.P11	Ndertime per N/stacione, kabina, transformatore, linja TN e te mesme dhe shperndarje e energjise	Punime izolimi, demontim percjellesi, F.V kabell ABC + aksesori F.V kabell furnizimi abonentesh + aksesori	C
N.S -18	Punime topogjeodezike	Largimi i dherave dhe kthimi i siperfaqes ne gjendjen e meparshme, piketim shtyllash	A

### 2.3.3 Certifikatat e cilësisë që duhet të dorëzojnë operatorët:

- EN-ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent
- EN-ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent
- BS OHSAS 45001 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalent

\*Te gjitha certifikatat e mesiperme duhet te jene te lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues.

\*Operatori ekonomik mund te paraqese certifikatat e mesiperme sipas standarteve shqiptare mbi komformitetin e standartit european dhe te leshuara nga organizma te vlersimit te konformitetit te akredituara ne Republiken e Shqiperise.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatat e mesiperme në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, citon: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

Komisioni i caktimit të kriterëve vendosi të kërkojë certifikatat e mesiperme për të vërtetuar cilësinë e punimeve që do të kryen nga O.E fitues. Certifikatat e kërkuara janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe respektojnë parimin e mosdiskriminimit.

**2.3.4** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse e stafit inxhinierik si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Elektrik

*Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatorët Ekonomik të Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8 të DST-ve.*

**2.3.5** Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e meposhtem.

- i. Libreze pune (perkatëse)
- ii. CV perkatëse
- ii. Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht

me objektin e kontrates, specifikimet teknike. Nevoja për inxhinierë në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të kenë në stafin e tij, 1 (një) punonjes që të disponojë certifikatë të trajnimit si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 10327 date 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" i ndryshuar dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" i ndryshuar.

*Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.*

**Argumentimi:** Kërkesa është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 39, pika 6 gërma "c", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë.

Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatëse në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Ç' do punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes

**2.3.7** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës**. Afati i punimeve duke gjykuar mbi natyrën dhe volumin e punimeve do të jetë **40 (dyzetë) ditë**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore shoqëruar me listëpagesat sipas formatit që kërkohet nga legjislacionin tatimor per periudhen 3-mujore (nëntor, dhjetor 2023 dhe janar 2024)
- b) List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen (nëntor, dhjetor 2023 dhe janar 2024)

*Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.*

**2.3.8** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën **15 (pesëmbëdhjetë) punonjës** te specializuar/kualifikuar, te pasqyruar ne listepagesat e shoqerise te pajisur me kontrate pune dhe deshmi profesionale (diplome, certificate trajnimi etj.), ku **6 (gjashtë) prej të cilëve të jenë elektrikist.**

*Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.*

**2.3.9** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **2 (dy) punonjës** manovratorë të mjeteve të rënda nga të cilet **1 (një) automakinist** dhe **1 (një) eskavatorist**. Për këta punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë ne rast se mjetet e punes (makinerite) jane ne pronesi te operatorit.

Ne rastet kur makinerit **disponohen me qira**, nuk eshte e nevojshme qe manovraret e mjeteve te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Ne kete rast ata duhet te kene te vlefshme vetem kontraten e punes dhe deshmitë e drejtimit.

*Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- Numri i fuqise punentore u llogarite duke u bazuar ne volumin e punimeve qe duhen kryer sipas projekt-preventivit, terrenit te veshtire dhe afatit **40 ditë** per kryerjen e punimeve. Ne baze te oreve te punes te marra nga analizat per secilin ze, u llogarite shifra prej **15 punonjës**.
- Komisioni/Grupi i ngritur per caktimin e kriterëve teknike vlerëson se te pakten 10 punonjes duhet te jene te specializuar, nga te cilet te pakten 6 (gjashte) të jenë elektrikist dhe me deshmine perkatëse te formimit. Keto deshmi duhet te kerkojen per shkak te natyres se punimeve, punonjesit duhet të kenë njohuri të plota mbi elektroteknikën, njohuri të plota të Rregullores së Sigurimit Teknik Elektrik, mbi rregullat e përdorimit të mjeteve mbrojtëse që përdoren në linjat



elektrike. Gjithashtu të kenë njohuri mbi impiantet elektrike (linjën elektrike), që të jenë të aftë nëpër caktimin, se cilat elemente duhet të hapen për kryerjen e punimeve, dhe të dijë të veprojë në zbatimin e masave të domosdoshme të sigurimit teknik elektrik.

- Operatori Ekonomik duhet te kete ne stafin e tij dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise: 1 (nje) Inxhinier Elektrik dhe 1 (nje) Inxhinier Ndertimi.
- qe te mbikeqyrin punimet ne fazen e zbatimit, keta inxhinier kane lidhje edhe me lincencat profesionale qe duhen per zbatimin e projektit.
- Në përcaktimin e numrit te punonjësve specialistet e fushës kanë bërë një analizë bazuar tek kategoritë e punimeve, terreni, kualifikimi i punonjësve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale te lejuar qe duhen per te permbushur kontraten. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje 3-mujore, (nëntor, dhjetor 2023 dhe janar 2024), tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën.
- Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.
- Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

**2.3.10** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	MJETET	SASIA	GJENDJA
1	Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5 (pese) ton dhe maksimumii 10 ( dhjete) ton	1 copë	Pronësi ose me qera
2	Kamioncinë me kapacitet deri në 3.5 (tre pike pese) ton	1 copë	Pronësi ose me qera
3	Autovinc 16-20 ton	1 cope	Pronësi ose me qira
4	Betoniere 500l	1 copë	Pronësi ose me qera
5	Vibrator	1 copë	Pronësi ose me qera
6	Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
7	Moto Gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera
8	Kambaleca per mbajtjen e barabaneve te kabllave	1 copë	Pronësi ose me qera
9	Kenetron per kablllo	1 copë	Pronësi ose me qera
10	Pajisje terheqese per kablllo me dinamometer	1 copë	Pronësi ose me qera

Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – jo më pak se 20 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën – jo më pak se 6 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë – jo më pak se 6 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – jo më pak se 6 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi – jo më pak se 6 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila – jo më pak se 2 copë

*a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerese / furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*

*b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*

*c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata perkatese noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*

*d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

*e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr.8. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*

Për mjetet e përmendura mësipër, drejtuesit e tyre të kenë leje drejtimi perkatesë.

*Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

1.-Analizat e çmimeve te zerave te preventivit jane marre ne baze VKM nr. 629 date 15.07.2015

2 -Analiza e çmimeve te zerave qe nuk jane ne fletoren zyrtare jane bere ne baze te librit Nr.6 " Montimi ilinjave dhe nestacioneve elektrike" dhe te manualit "Preventivimi per rrjetat elektrike komunal" sipas udhezimit nr.2 date 08.05.2003 mbeshtetur ne VKM nr.8402 date 10.09.1998

- 3 - Çmimet e bazes materiale janë marre ne Drejtorine ekonomike te OSHEE (SAP - i)
- 4 - Volumet e germimeve, betonimeve dhe te montimeve janë marre sipas standarteve te OSHEE bashkëngjitur projektit.
- 5 - Paga orare është marre mesatarja e nje punonjesi te OSHEE 185 leke
- 6 - Sigurimet shoqerore janë marre 16.7 % sipas VKM nr. 629 date 15.07.2015.
- 7 - Per pumimet e ndertimit e te montimit ne baze te udhezimit Nr. 2 te date 08.05.2003 te VKM Nr. 8402 date 10.09.1998 është marre shtesa 50 % mbi page.
- 8 - Shpenzimet plotesuese janë marre 5 % sipas VKM nr. 629 date 15.07.2015.
- 9 - Norma e fitimit është marre 10 % sipas VKM nr. 629 date 15.07.2015.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

### 2.3.11 Per Listen e meposhteme te artikujve:

- Panel TU
- Elektroda tokezimi
- Terminal kablli XLPE gershet
- Shtylla betonarme te centrifuguara
- Kabell TU fuqie XLPE AL
- Kabell TU me vetembajtje ABC AL
- Tirantues /qafore / konektor
- Kabell TU Cu PVC
- Percjelles ALÇ – 35mm<sup>2</sup>
- Izolatore TM -10kV
- Ndares TM 3P, 12.5kV, 400A
- Shkarkues ventil TM -10kV
- Siguresa TM -10kV
- Tranversa Y tek dhe dopio izolator per faze.

Operatori ekonomik duhet te paraqese:

- *Operatori ekonomik në rastin kur nuk është prodhues duhet të vërtetojë me marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit*

*dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike ose ekuivalenti i tij/saj) nga të cilat specifikimet teknike të produkteve të kerkuara të jene ne gjuhen e ofertes.*

- *Katalog/skede teknike të prodhuesit ku të paraqiten specifikimet teknike të ofertuara*

**2.3.12** Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë një Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet se, brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent.

---

**Sqarim:** Cdo kriter i parashikuar në nenin 26, pikë 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe në shtojcën nr. 8 të Dokumentave Standarte të Tenderit, përmbushet nga Operatorët Ekonomikë nepermjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8 të DST-ve.

Në bazë të nenit 26, pikë 6, i VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>1</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomik, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. ( neni 88, pikë 3 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” )

Në funksion të plotësimit të Shtojcës 8 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emer, Mbiemër, Ates, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuara të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose

---

<sup>1</sup> Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

te huaj), per Administratorin/Administratores e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.

Specifikimet teknike, raporti teknik, preventivi me zerat e punimeve jane pjese e pandare e DST.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

## **NJESIA E PROKURIMIT**